



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë  
MINISTRIA E ARSIMIT  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË  
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

## TESTI FIZIKË

### FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

#### NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE \_\_\_\_\_  
VENDI \_\_\_\_\_  
KOMUNA \_\_\_\_\_


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <https://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra dhjetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

**Shifra e veçantë e testit:** 170620260835

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

## UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për plotësimin e testit në dispozicion ke **120 minuta**.
- Detyrat nuk është e thënë t'i zgjidhësh sipas radhitjes së paraqitur.
- Gjatë punës mund të përdorësh laps grafik dhe gomë, por nuk mund ta përdorësh kalkulatorin dhe telefonin mobil.
- Përgjigjet përfundimtare dhe ecurinë shkruaji me **laps kimik ngjyrë të kaltër**.
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps grafik, laps kimik me ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuar.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Ke kujdes, ngase detyrat dallojnë nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet (  ), të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat të cilat kanë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rrathë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e saktë.

SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR	
Tek detyra me një përgjigje të saktë	
Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.	
<input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevci	
Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta	
Ngjyros rrathët para shprehjes, shuma e të cilës është 5.	
<input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5	


- Nëse e përfundon testin më herët se sa koha që është paraparë, atëherë dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR  
**TESTI  
FIZIKË**


1. Nëse kubi metalik shtyhet që të rrëshqas mbi tavolinën e lëmuar, do të ndalet pas pak kohe. Cila forcë e ndalon këtë trup? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ forca e fërkimit
- ☐ pesha e trupit
- ☐ forca e gravitacionit
- ☐ asnjë forcë, ndalon vetvetiu



2. Çka mundemi të konkludojmë për elektrizimin e topit plastik i cili largohet nga shkopi i elektrizuar pozitivisht pasi t'i ofrohet shkopi? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ është elektrizuar negativisht
- ☐ është elektrizuar pozitivisht
- ☐ nuk është i elektrizuar



3. Cila nga lëvizjet e cekura është oscilatore? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ lëvizja e trupit gjatë rënies së lirë
- ☐ lëvizja e automjetit në rrugën malore
- ☐ lëvizja e trupit në rrafshin e pjerrtë
- ☐ lëvizja e luhatësës (shilarësës) së fëmijëve

4. Kërmilli i vreshtit shpesh lë gjurmë (jargë) ngjyrë argjendi pas veti. Kërmilli në figurë gjatë çdo minute kalon nga 30 centimetër. Çfarë është lëvizja e tij?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ lëvizje e njëtrajtshme drejtvizore
- ☐ lëvizje e ndryshueshme drejtvizore
- ☐ lëvizje e njëtrajtshme vijëpërkulur
- ☐ lëvizje e ndryshueshme vijëpërkulur




5. Sa kohë i duhet autobusit që të kalojë rrugën me gjatësi e 240 kilometër duke lëvizur me shpejtësi mesatare  $60 \frac{\text{km}}{\text{h}}$ ?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ 2 h                      ☐ 4 h                      ☐ 6 h                      ☐ 8 h


6. Nxënësi ka një baski rreth së cilës e krijon bobinën(solenoidin) me tel bakri. Çka i mungon që këtë mjet ta përdorë si elektromagnet?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ gjilpëra e kompasit
- ☐ magneti
- ☐ burimi i rrymës elektrike
- ☐ nuk i mungon asgjë




7. Sa është ndarja më e vogël në shkallën në ampermetrin e paraqitur në figurë?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ 0 A
- ☐ 0,5 A
- ☐ 1 A
- ☐ 5 A



8. Cila madhësi fizike matet me mjetin e paraqitur në figurë?



Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ shtypja atmosferike
- ☐ lagështia e ajrit
- ☐ temperatura e ajrit
- ☐ intensiteti i forcës


9. Gjatë shpimit të gypave të plastikës me trapan plastika është shkrire dhe është ngjitur për burgi. Për çka u shkri plastika?

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ Për arsye se plastika ngrohej gjatë fërkimit mes burgijës dhe plastikës.
- ☐ Për arsye se fusha magnetike të cilën e krijon trapani e ngroh plastikën.
- ☐ Për arsye se burgija është krijuar nga materiali që e grin plastikën.
- ☐ Për shkak se plastika e përthith nxehtësinë nga ajri.

10. Në figurë janë paraqitur forcat të cilat veprojnë në anijen në det. Cila nga forcat e cekura ka drejtimin dhe kahjen e forcës së shtytjes? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐  $\vec{F}_1$
- ☐  $\vec{F}_2$
- ☐  $\vec{F}_3$
- ☐  $\vec{F}_4$




- 11.** Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.  
Kur në trupin i cili lëviz me shpejtësi të njëtrajtshme, fillon të veproj forca në kahjen e lëvizjes, trupi:

- ☐ zvoglon shpejtësinë;
- ☐ rrit shpejtësinë;
- ☐ nuk e ndryshon shpejtësinë;
- ☐ ndalet.

- 12.** Trupi është varur në sustën elastike dhe oscilon mes pikave 1 dhe 2, siç është paraqitur në figurë. Me çka është e barabartë distanca mes pikave 1 dhe 2?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ çerekun e vlerës së amplitudës
- ☐ gjysmës së vlerës së amplitudës
- ☐ vlerës së amplitudës
- ☐ dyfishin e vlerës së amplitudës




- 13.** Dy burime të njëjta elektrike (bateria) me nga 3 V janë lidhur në rend. Sa është tensioni i përgjithshëm në skajet e lidhjes së tyre?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ 1,5 V
- ☐ 3,0 V
- ☐ 6,0 V
- ☐ 9,0 V

14. Shkronja e madhe latine **W** është simbol i njësisë matëse i cilës madhësi fizike?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ për punën
  - ☐ për fuqinë
  - ☐ për intensitetin e rrymës elektrike
  - ☐ për tensionin
15. Telat (përçuesit) që gjenden në shtylla për bartjen e rrymës elektrike gjatë verës janë të lëshuara më poshtë, ndërsa dimrit më të shtrënguara.  
Si e sqaroni këtë dukuri?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ Sepse gjatë verës lagështia është më e madhe dhe ndikon në zgjatjen e përçuesve.
  - ☐ Për shkak se gjatë ngrohjes përçuesit bymehen dhe zgjaten, e gjatë ftohjes tkurren.
  - ☐ Sepse gjatë verës rrjedh rryma më madhe se sa dimrit, për shkak të harxhimeve më të vogla.
  - ☐ Për shkak se punëtorët e mirëmbajtjes gjatë dimrit i shtrëngojnë më shumë përçuesit.
16. Energjia kinetike përshkruhet me formulën  $E_k = \frac{m \cdot v^2}{2}$ .  
Si ndryshon energjia kinetike nëse shpejtësia e trupit rritet dyfish?  
Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.
- ☐ rritet 2 herë
  - ☐ rritet 4 herë
  - ☐ zvogëlohet 2 herë
  - ☐ zvogëlohet 4 herë
  - ☐ nuk ndryshon

17. Kolovajza e vogël në figurë gjendet në barazpeshë. Në njërin skaj qëndron maca në distancën 1 m nga pika mbështetëse, ndërsa në tjetrin akuarijumi në 0,4 m nga pika mbështetëse. Nëse masa e macës është 4 kg, sa është masa e akuariumit? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ 0,6 kg
- ☐ 1,6 kg
- ☐ 10 kg
- ☐ 16 kg
- ☐ 100 kg




18. Automobili lëviz me shpejtësi prej  $10 \frac{\text{m}}{\text{s}}$ . Meqenëse e vërejtë që është dhezuar drita e kuqe e semaforit, vozitësi filloi të frenojë me nxitim  $2 \frac{\text{m}}{\text{s}^2}$ . Nëse llogaritet nga momenti i frenimit, sa kohë i duhet që të ndalet automjeti?

Shpejtësia të lëvizja njëtrajtësisht e ngadalsuar drejtvizore llogaritet sipas formulës  $v = v_0 - at$ . Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐ 2 s
- ☐ 5 s
- ☐ 10 s
- ☐ 20 s

19. Tre rezistues me nga  $5 \Omega$  rezistencë janë të lidhur si në figurë. Sa është rezistenca e rezistuesit ekuivalent  $R_{12}$  mes pikave 1 dhe 2? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- ☐  $R_{12} = 15 \Omega$
- ☐  $10 \Omega < R_{12} < 15 \Omega$
- ☐  $5 \Omega < R_{12} < 10 \Omega$
- ☐  $R_{12} = 5 \Omega$





- 20.** Guri është lëshuar nga dora të bie lirshëm. A ndryshojnë dhe si ndryshojnë energjia kinetike, potenciale gravitacionale e gurit?

Nëse pohimi është i saktë, ngjyros rrethin në kolonën SAKTË, e nëse nuk është e saktë, ngjyros rrethin në kolonën e PASAKTË.

	Saktë	Pasaktë
Energjia kinetike rritet.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Energjia potenciale nuk ndryshon.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Energjia potenciale zvogëlohet.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Energjia kinetike zvogëlohet.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

# FAQE E ZBRAZËT

# FAQE E ZBRAZËT



Republika e Serbisë  
MINISTRIA E ARSIMIT  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË  
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI  
FIZIKË

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

SHKOLLA FILLORE  
VENDI  
KOMUNA


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR